

VENDIM
Nr. 800, datë 30.9.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ZBATIMIN E KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas nenit 231 shtohet neni 231/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 231/1

Kriteret që duhet të plotësojë subjekti dhe rregullat për kontrollin dhe verifikimin e përputhjes me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre, që prodhohen dhe importohen

(Neni 76 i Kodit Rrugor)

1. Subjekti, që do të kryejë shërbimin e kontrollit dhe të verifikimit të përputhjes me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre, që prodhohen dhe importohen në Republikën e Shqipërisë (që më poshtë do të quhet Subjekti i Kontrollit dhe Verifikimit), duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme.

1.1 Të ketë përvojë të suksesshme mbi 5 (pesë) vjet në realizimin e shërbimeve në fushën e homologimit të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre.

1.2 Të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose të licencave sipas kërkesave të ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e shërbimit të kontrollit dhe të verifikimit të përputhjes me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre (që më poshtë do të quhet Shërbimi i Kontrollit dhe i Verifikimit).

1.3 Të ketë personel drejtues/menaxhues teknik me përvojë pune më shumë se pesëvjeçare në fushat përkatëse të homologimit, me dëshmi /certifikata nga vendet e BE-së, në mënyrë që të garantojë me kompetencë dhe me cilësi këtë shërbim.

1.4 Të ketë staf të mjaftueshëm profesional teknik, i cili të ketë përgatitjen e nevojshme profesionale, me dëshmi/certifikata nga vendet e BE-së, përvojë pune më shumë se trevjeçare në këtë fushë, në mënyrë që të kryejë me cilësi këtë shërbim.

1.5 Të ketë qendra të kontrollit dhe të verifikimit të përputhjes me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre (që më poshtë do të quhen qendra të kontrollit dhe të verifikimit) të shpërndara në territorin e Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit, me kushte të mjaftueshme materiale-teknike dhe kapacitete operationale, që të garantojnë funksionimin e përshtatshëm në ushtrimin e këtij shërbimi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Qendrat e kontrollit dhe të verifikimit duhet të kenë:

- a) sipërfaqen totale jo më pak se 1 200 (një mijë e dyqind) m²;
- b) zyra të mjaftueshme për administratën, me sipërfaqe jo më pak se 150 (njëqind e pesëdhjetë) m²;
- c) hapësirën për kontrollin dhe për verifikimin e përputhjes me tipin e homologuar, me sipërfaqe jo më pak se 250 (dyqind e pesëdhjetë) m²;
- ç) vend për parkimin e mjeteve që do të kryejnë kontrollin dhe verifikimin e përputhjes me tipin e homologuar me sipërfaqe jo më pak se 800 (tetëqind) m²;

d) pajisje kompjuterike së bashku me *software*-ët aplikativë nga fusha përkatëse e homologimit të mjeteve rrugore për verifikimin e karakteristikave të mjeteve rrugore;

dh) pajisjet teknike të nevojshme e të domosdoshme për kontrollin dhe verifikimin e kërkesave e të parametrave teknikë të mjeteve rrugore.

1.6 Të sigurojë vazhdimisht paanshmëri profesionale në marrëdhëniet me grupet e interesit (personat fizikë apo juridikë) të cilët janë të varur në mënyrë direkte apo indirekte nga rezultati i kontrollit dhe të verifikimit të përputhjes me tipin e homologuar të mjetit rrugor për të cilin konstatohet përputhshmëria.

1.7 Të ketë akreditimet/certifikimet në fushën e shërbimeve profesionale sipas standardeve ndërkombëtare ISO 17020 dhe ISO 17025.

1.8 Të ketë certifikatën për menaxhimin e cilësisë ISO 9001 dhe për menaxhimin e sigurisë së informacionit ISO 27001, si dhe sipas legjislacionit të fushës për të siguruar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

1.9 Të ketë një sistem unik dhe uniform të ofrimit të Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore në të gjitha qendrat e kontrollit dhe verifikimit.

1.10 Të ketë kapacitetet e nevojshme për monitorimin e Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore në kohë reale, përmes sistemeve të teknologjisë informative.

1.11 Të ketë nën vëzhgim me sistemin elektronik të kamerave të gjitha qendrat e kontrollit dhe të verifikimit ku kryhen shërbimet e kontrollit dhe të verifikimit të mjeteve rrugore etj.

1.12 Të jetë subjekt juridik dhe pas përzgjedhjes të jetë i siguruar për përgjegjësinë në ushtrimin e veprimtarisë së këtij shërbimi.

1.13 Të informojë rregullisht ministrinë përgjegjëse për transportin me anë të një raporti mujor me shkrim për gjendjen (funksionale, teknike, kapacitetin etj.) dhe sasinë e mjeteve rrugore që kanë kryer e Kontrollit dhe të Verifikimit, në çdo Qendër të Kontrollit dhe Verifikimit.

2. Shërbimi i Kontrollit dhe i Verifikimit të mjeteve rrugore do të jepet me koncesion /partneritet publik privat në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.1 Përzgjedhja e subjektit, që do të kryejë Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore, do të realizohet nëpërmjet procedurave transparente dhe konkurruese në përputhje me ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.

2.2 Autoriteti kontraktues për dhënien me koncesion të Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore në Republikën e Shqipërisë është ministria përgjegjëse për transportin.

2.3 Për të kryer Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore, subjekti i shpallur fitues nga procedurat konkurruese të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, do të nënshkruajë kontratën me autoritetin kontraktues, ministrinë përgjegjëse për transportin.

3. Shërbimi i Kontrollit dhe i Verifikimit do të kryhet përpara veprimeve të regjistrimit të mjeteve me motor, rimorkiove dhe sistemeve të tyre, të reja dhe të përdorura, që prodhohen ose importohen në Republikën e Shqipërisë.

3.1 Shërbimi i Kontrollit dhe i Verifikimit të mjeteve rrugore nuk do të aplikohet, për:

- a) mjetet rrugore të projektuara dhe të prodhuara për/dhe në emër të ushtrisë;
- b) mjetet rrugore të projektuara dhe të prodhuara për/dhe në emër të shërbimit zjarrfikës;
- c) mjetet rrugore të projektuara dhe të prodhuara për/dhe në emër të policisë;
- ç) mjetet rrugore me destinacion të veçantë dhe të përjashtuara nga autoriteti kontraktues, ministria përgjegjëse për transportin.

3.2 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të prodhuara në seri në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit, për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë, përpara kryerjes së regjistrimit të tyre.

3.3 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të prodhuara individualisht në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë, përpara kryerjes së regjistrimit të tyre.

3.4 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të reja, të importuara në seri në Republikën

e Shqipërisë, duhet të kryejnë Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit, për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë, përpara kryerjes së veprimeve të regjistrimit të tyre.

3.5 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të reja, të importuara individualisht në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit, për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë, përpara kryerjes së veprimeve të regjistrimit të tyre.

3.6 Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të përdorura, të importuara në Republikën e Shqipërisë, duhet të kryejnë Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit, për të përcaktuar shkallën e përputhshmërisë, përpara kryerjes së veprimeve të regjistrimit të tyre.

3.7 Mjete të përdorura do të konsiderohen mjetet rrugore të cilat janë të regjistruara në shtete të tjera dhe që importohen në Republikën e Shqipërisë.

4. Kategoritë e mjeteve rrugore, që do të kryejnë Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit përpara kryerjes së veprimeve të zhdoganimit ose të regjistrimit të tyre, janë:

4.1 Ciklomotorët dhe motomjetet e kategorive L1, L2, L3, L4, L5, L6 dhe L7, të përcaktuara në nenin 47 të Kodit Rrugor.

4.2 Mjetet për transport njerëzish me të paktën 4 rrota të kategorive M1, M2 dhe M3, të përcaktuara në nenin 47 të Kodit Rrugor.

4.3 Mjetet për transport mallrash me të paktën 4 rrota të kategorive N1, N2 dhe N3, përcaktuar në nenin 47 të Kodit Rrugor.

4.4 Rimorkiot edhe gjysmërimorkiot të kategorive O1, O2, O3 dhe O4, përcaktuar në nenin 47 të Kodit Rrugor.

5. Procedura për kryerjen e Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore nga subjekti që plotëson kushtet dhe është i përzgjedhur nga autoriteti kontraktuese është, si më poshtë vijon.

5.1 Personi i interesuar ose përfaqësuesi i prodhuesit të mjeteve bën kërkesën për kryerjen e procedurës së Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit, si dhe dërgon mjetin rrugor te subjekti i përzgjedhur për kryerjen e këtij shërbimi.

5.2 Kërkesës për zbatimin e procedurës së Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore të reja i bashkëlidhet një nga dokumentet: kopje e homologimit të tipit të mjetit nga prodhuesi, të dhënat teknike për mjetin rrugor nga prodhuesi, certifikata e përputhshmërisë së mjetit, rimorkios, pajisjeve dhe pjesëve të mjetit (certifikata e përputhshmërisë nga prodhuesi për mjetet e prodhuara në seri, COC, apo lista e direktivave/rregulloreve ndërkombëtare që përmbush mjetin rrugor i prodhuar individualisht).

5.3 Kërkesës për zbatimin e procedurës së Shërbimit të Kontrollit dhe Verifikimit të mjeteve rrugore të përdorura i bashkëlidhet një nga dokumentet: të dhënat teknike për mjetin rrugor nga prodhuesi, certifikata e përputhshmërisë së mjetit nga prodhuesi, leja e qarkullimit etj.

6. Qëllimi i Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore nga subjekti që plotëson kushtet dhe është i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues është kontrolli dhe verifikimi vlerësues i mjeteve rrugore para regjistrimit për përputhshmërinë me tipin e homologuar.

6.1 Shërbimi i Kontrollit dhe i Verifikimit të mjeteve rrugore që importohen në Republikën e Shqipërisë ka të bëjë me zbatimin e procedurës së:

- a) kontrollit identifikues të mjetit rrugor;
- b) verifikimit me tipin e miratimit të mjeteve të reja apo të përdorura, pavarësisht nëse janë të riparuar apo të modifikuara etj;
- c) identifikimit dhe verifikimit të pjesëve, pajisjeve e sistemeve të tyre.

6.2 Shërbimi i Kontrollit dhe i Verifikimit të mjeteve rrugore ka të bëjë dhe me procedurën e kontrollit të plotësimit të kërkesave teknike që garantojnë siguri në qarkullim, mbrojtje të shëndetit të njerëzve e të mjedisit, si dhe kërkesat e tjera të ndërlidhura me këto mjete, rimorkio apo sisteme të tyre.

6.3 Plotësimi i kërkesave teknike konsiderohet në harmoni të plotë kur, nga kontrolli dhe verifikimi identifikues në dokumentacionin e prejardhjes së mjetit dhe në mjet, është konstatuar se ekziston përputhshmëri me kërkesat e përcaktuara teknike, të cilat janë në përputhje me rregulloret

respektive ndërkombëtare dhe që përmbushen të gjitha kushtet e përcaktuara.

6.4 Pas Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore, kur plotësohen kushtet e përputhshmërisë me tipin e homologuar, subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues lëshon vërtetimin e përputhshmërisë me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe sistemeve të tyre (që më poshtë do të quhet vërtetimi i përputhshmërisë).

6.5 Pas Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore, kur nuk plotësohen kushtet e përputhshmërisë me tipin e homologuar, subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues nuk lëshon vërtetimin e përputhshmërisë.

6.6 Për të rregulluar ose për plotësuar kushtet e përputhshmërisë me tipin e homologuar të mjeteve rrugore, subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues do të përcaktojë një periudhë kohore të arsyeshme, afat deri në 60 ditë, për të bërë përmirësimet e nevojshme nga personi i interesuar.

6.7 Kur dhe mbas periudhës për të bërë përmirësimet e nevojshme, të përcaktuar nga subjekti i përzgjedhur për të kryer Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit, rezulton përsëri jo në përputhje me tipin e homologuar, subjekti i përzgjedhur nuk lëshon vërtetimin e përputhshmërisë dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor që të mos lejohet të kryhen veprimet e regjistrimit për këto mjete rrugore.

6.8 Modeli i vërtetimit të përputhshmërisë me tipin e homologuar të mjeteve me motor, të rimorkiove dhe të sistemeve të tyre përgatitet nga subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues dhe miratohet nga ministri përgjegjës për transportin.

7. Ankimimi ndaj refuzimit të lëshimit të vërtetimit të përputhshmërisë pas Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore me tipin e homologuar.

7.1 Kundër refuzimit të lëshimit të vërtetimit të përputhshmërisë së mjetit rrugor, sipas pikës 5.5, të këtij neni, mund të bëhet ankimim sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative pranë autoritetit mbikëqyrës të subjektit të përzgjedhur, në Këshillin e Ekspertëve të mjeteve rrugore të ministrisë përgjegjëse për transportin.

7.2 Këshilli i Ekspertëve të mjeteve rrugore përbëhet nga pesë anëtarë, të kualifikuar në fushën përkatëse dhe miratohet nga ministri përgjegjës për transportin.

7.3 Anëtarët e Këshillit të Ekspertëve rekomandohet të jenë inxhinierë të kualifikuar në fushën përkatëse: dy nga bota akademike e fushës përkatëse, dy nga ministria përgjegjëse për transportin dhe që mbulojnë fushën përkatëse dhe një nga subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues për të kryer Shërbimin e Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore.

7.4 Këshilli i Ekspertëve shqyrton ankesat për refuzimin e lëshimit të vërtetimit të përputhshmërisë së mjetit rrugor sipas aktit nënligjor të ministrit përgjegjës për transportin, brenda afatit kohor prej 15 ditësh nga data e pranimi të ankesës.

7.5 Këshilli i Ekspertëve, pasi shqyrton ankesën dhe kërkesat e palëve, jep rekomandime dhe ide konstruktive teknike për gjetjen e zgjidhjes, për të kryer ndryshimet e nevojshme në funksion të përputhshmërisë me kriteret e kërkuara për mjetet rrugore.

8. Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë, duhet të jenë të pajisura me vërtetimin e përputhshmërisë me tipin e homologuar nga subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues, në përputhje me pikat e këtij neni, në mënyrë që të mund t'u kryhen veprimet e regjistrimit të tyre nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

9. Mjetet me motor, rimorkiot dhe sistemet e tyre, të cilat prodhohen në Republikën e Shqipërisë, duhet të jenë të pajisura me vërtetimin e përputhshmërisë me tipin e homologuar nga subjekti i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues, në përputhje me pikat e këtij neni, në mënyrë që të mund t'u kryhen veprimet e regjistrimit të tyre nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

10. Zgjidhja e kontratës së Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore me koncesion/partneritet publik privat kryhet, si më poshtë vijon.

10.1 Autoriteti kontraktues gëzon të drejtën të zgjidhë kontratën e koncesionit/partneritetit publik

privat në mënyrë të njëanshme, në rast se subjekti që plotëson kushtet dhe është i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues nuk plotëson detyrimet dhe kushtet e Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore.

10.2 Detyrimet dhe kushtet e Shërbimit të Kontrollit dhe të Verifikimit të mjeteve rrugore do të parashikohen shprehimisht në kontratën e koncesionit/partneritetit publik privat ndërmjet autoritetit kontraktues dhe subjektit që plotëson kushtet dhe është i përzgjedhur nga autoriteti kontraktues.”.

2. Në pikën 1, të nenit 232, fjalët “... pranë degëve në rrethe të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në bazë të vendndodhjes së shoqërisë që ka bërë modifikimin ...” zëvendësohen me “... pranë subjektit të licencuar nga ministri përgjegjës për transportin, sipas kritereve të përcaktuara në aktin nënligjor të ministrit ...”.

3. Në pikën 2, të nenit 232, fjalët “... zyra përkatëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas përcaktimeve të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transporteve ...” zëvendësohen me “... pranë subjektit të licencuar nga ministri përgjegjës për transportin, sipas përcaktimeve në aktin nënligjor të ministrit ...”.

4. Në pikën 1, të nenit 248, pas shkronjës “I” shtohet shkronja II”, me këtë përmbajtje:

“II) Targa e mjeteve rrugore të Ministrisë së Mbrojtjes: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat jeshilë të errët. Shenja dalluese MM (Ministria e Mbrojtjes), figura III.4/1.m, figura III.4/2.m dhe figura III.3/g.”.

5. Në pikën 1, të shtojcës X, pas shkronjës “n” shtohen shkronjat “nj” dhe “o”, me këtë përmbajtje:

“nj) Targa e mjeteve rrugore të Ministrisë së Mbrojtjes (e përparme dhe e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike “MM”, tri karaktere numerike dhe dy karaktere alfabetike (figurat III.4/1.m dhe figura III.4/2.m).

o) Targa e motomjeteve të Ministrisë së Mbrojtjes (e pasme) mban, sipas radhës, emblemën, dy karaktere alfabetike “MM”, dy karaktere numerike dhe një karakter alfabetik (figura III.3/g).”.

II. Ngarkohen ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama